



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2684, datë 31.08. 2016

Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Reçi, në mbledhjen e datës 31.08.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave”.

BAZA LIGJORE:

- 1) Ligj nr. 44/2015 datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative” (**K.Pr.A**);
- 2) Ligji nr.9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**) Neni 8 gërma f), Neni 133, neni 134, neni 135;
- 3) Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2015” (**Rekomandimet për vitin 2016**).
- 4) Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.
- 5) Urdhër i AKEP nr.1795 datë 8.06.2016 për hartimin e akteve normative administrative: 1.“Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, 2.“Rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave” .

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Relacionin shpjegues mbi çështjen në shqyrtim dhe aktin e propozuar për miratim
- Dokumenti për këshillim publik “Rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave”.
- Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

Dokumenti për këshillim public “*Rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave*” është hartuar me qëllim, hartimin e procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave në mënyrë që, përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit, spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore si dhe kompetencat e AKEP, të ofrojë të dhëna të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, verifikimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara, të ofrojë informacione të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vendeve fqinje në eliminimin e interferencave të dëmshme, si dhe identifikimin e pastrimit të transmetimeve jashtë brezi.

Kjo rregullore është hartuar bazuar në:

- a) përcaktimet e Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 8 gërma f) ku përcaktohet se, AKEP monitoron përdorimin e spektrit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave; pika 3 e nenit 133 “*Monitorimi i frekuencave bëhet në përputhje me rregulloren përkatëse, të hartuar nga AKEP-i*”,
- b) domozdoshmërinë e përputhjes me strukturën e re të AKEP, miratuar me Vendim Nr. 88/2015, datë 15.10.2015 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet ngritja e Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, ngritja e Sektorëve të Planifikimit dhe Kordinimit të Monitorimit dhe Inspektimit, si dhe ngritja e Sektorëve Rajonalë të Monitorimit dhe Inspektimit.
- c) Implementim i “Projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Spektrit të Frekuencave”, qëllimi i të cilit është trajtimi i karakteristikave thelbësore të teknikave dhe veprimtarisë së monitorimit të spektrit në një sistem kombëtar.

Në përgatitjen e dokumentit(GP) ka marrë në konsideratë: Përcaktimet e Radio Rregullore të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU) dhe Udhëzues mbi Monitorimin e Spektrit (*Handbook on Spectrum Monitoring - ITU*) si dhe *Rekomandimet për vitin 2016*, të përcaktuara në Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2015.

Dokumenti paraqet një hap të rëndësishëm në procesin të përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullator dhe qasjen me risitë në procesin e monitorimit në nivel evropian.

PËR KËTO ARSYE:

Pasi e gjen dokumentin në përputhje me kërkesat ligjore në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 dhe pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të AKEP miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP , duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Periudha e këshillimit publik është 30 ditë nga data e publikimit të dokumentit në faqen e Internetit të AKEP.
3. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar të publikohen në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RR E G U L L O R E

Nr._____, datë __.__.2016

PËR

“MONITORIMIN E SPEKTRIT TË FREKUENCAVE”

KAPITULLI I

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i monitorimit

1. Qëllimi i Rregullores është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave me qëllim që:
 - a) përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit;
 - b) spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - c) të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore si dhe kompetencat e AKEP.
 - d) të ofrojë të dhëna të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, verifikimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara;
 - e) të ofrojë informacione të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vëndeve fqinje në eliminimin e interferencave të dëmshme, si dhe identifikimin e pastrimit e transmetimeve jashtë brezi.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i rregullores është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave me qëllim që spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe krijimi i një mjedisi të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

Neni 3

Baza Ligjore

Kjo Rregullore hartohet në zbatim të nenit 133, nenit 134, nenit 135 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 8 gërma a), f), l) dhe p), të po këtij Ligji¹

¹Në hartimin e kësaj rregulloreje janë marrë në referencë përcaktimet e Radio Rregullore të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU) dhe Udhëzues mbi Monitorimin e Spektrit (Handbook on Spectrum Monitoring - ITU).

KAPITULI II

MONITORIMI I SPEKTRIT TE FREKUENCAVE

Neni 7

Organizimi i Veprimtarisë së Monitorimit në AKEP

1. Monitorimi i spektrit të frekuencave kryhet nga:
 - a) Sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave,
 - b) Sektori i Planifikimit dhe Koordinimit të Monitorimit dhe Inspektimit
 - c) Sektorët Rajonale të Monitorimit,në përbërje të Drejtorisë së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimeve (DMFCI).
2. Kontrolli i gjithë sistemit të monitorimit do të bëhet nga Qendra Kryesore e Kontrollit (MCC), pjesë e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave (QKMF), në Tiranë. Nga MCC është e mundur të kontrollohen në distancë gjithë Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) dhe Stacionet e Thjeshtë Fiks të Monitorimit (SRFMS).
3. Veprimtaria e personelit të monitorimit në Sektorët Rajonale organizohet nga Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Qendres Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave dhe koordinohet nga Drejtori i Drejtorisë së Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimeve.

Neni 6

Llojet e stacioneve të monitorimit

Llojet e stacioneve të monitorimit:

1. *Stacion Fiks Monitorimi*: Stacionet Fikse të Monitorimit janë elementi qendror i sistemit të monitorimit dhe në zonën e tyre të mbulimit ata mundësojnë kryerjen e të gjitha matjeve fikse.
2. *Stacion i Lëvizshëm Monitorimi*: Stacionet e lëvizshëm të monitorimit kanë funksionin e kryerjes e të gjitha operacioneve monitorues kur fuqia e vogël e transmetuesve, drejtueshmëria e lartë e antenave apo karakteristika të veçanta të përhapjes bëjnë të pamundur që matjet të kryhen nga stacionet fikse.

Neni 8

Monitorimi nga Stacionet Fikse

1. Stacionet Fikse të Monitorimit (RFMS) do të kontrollohen në distancë nga Qendra Kombëtare e Monitorimit të Frekuencave (QKMF) nëpërmejt softëare përkatës të monitorimit.

2. Monitorimi Fiks do të kryhet mbi bazën një plani periodik, për zbatimin e detyrave të monitorimit që burojnë nga Radio Rregulloret e ITU (ITU-R) dhe në përputhje me manualin e ITU (Monitoring Handbook – ITU), rekomandimet/vendimet CEPT.
3. Monitorimet do të programohet automatikisht në sistem dhe do të ekzekutohen sipas Planit Mujor Operacional për Stacionet Fikse të Monitorimit në Sektorët Rajonalë, sipas zonave përkatëse të mbulimit.
4. Matjet për investigimin e rasteve të interferencave do të kryhen kur administrohet një ankesë për interferencë të demshme, në përputhje me përcaktimet e *Rregullores Nr.35 datë 23.12.2014 “Për Administrimin e Interferencave”* dhe do të kenë prioritet ekzekutimi.

Neni 9

Monitorimi nga Stacionet e Lëvizshëm

1. Stacionet e lëvizshëm monitorues kanë funksionin e kryerjes e të gjitha operacioneve monitorues kur fuqia e vogël e transmetuesve, drejtueshmëria e lartë e antenave apo karakteristika të veçanta të përhapjes bëjnë të pamundur që matjet të kryhen nga stacionet fikse.
2. Për kryerjen e monitorimit të lëvizshëm përdoret Qendra e Lëvizshme e Monitorimit të Spektrit të Frekuencave – QLMSF, si dhe çdo pajisje tjetër e disponueshme e transportueshme.
3. Monitorimi në terren mund të kryhet në çdo kohë dhe në çdo ambient, në përputhje me parashikimet e ligjit 9918/2008 i ndryshuar.
4. Përdorimi i pajisjeve të monitorimit bëhet në përputhje me instruksionet që përshkruajnë rrjedhën e punës dhe procedurat standarde të matjeve, duke u bazuar në Manualin e Monitorimit (Monitoring Handbook – ITU) dhe manualin e pajisjeve.
5. Çdo pengesë për kryerjen e detyrës së monitorimit përbën kundravajtje administrative dhe do të ndëshkohet sipas parashikimeve të Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe do të njoftohen organet e Policisë së Rendit për bashkëveprim/mbështetje sipas ligjit, ose do të bashkëpunohet me autoritetet publike vendore në përputhje me termat e marrëveshjes së bashkëpunimit me këto institucione.

Neni 10

Detyrat kryesore të monitorimit

1. Detyrat kryesore të monitorimit, në përputhje me Radio Rregulloret e ITU (ITU-R) janë:
 - a) monitorimi i emetimeve për të kontrolluar respektimin e kushteve të lidhur me caktimin e frekuencave,
 - b) mbikqyrja e brezave të frekuencave dhe matja e zënies së kanaleve të frekuencave;
 - c) investigim i rasteve të interferencave
 - d) identifikimi dhe ndalimi i transmetimeve të pa-autorizuar;

- e) ndihmon në raste të veçanta si ngjarjet e mëdha sportive dhe vizitat shtetërore;
- f) kryen studime teknike dhe shkencore;

2. Për mbështetjen e aktiviteteve Verifikues:

- a) Okupimi i Brezit të Frekuencave (FBO)
- b) Okupimi i Kanalit të Frekuencave (FCO)
- c) Matje të modulimit/devijimit
- d) Matje të intensitetit të fushës (përfshirë matjet e fuqisë dhe densitetin e fluksit të fuqisë PFD)
- e) Matje të gjërësisë së brezit
- f) Matje të mbulimit
- g) Matje të frekuencës
- h) Analizë e sinjalit dhe identifikim të transmetuesit
- i) Matje mikrovalore
- j) Analiza rreth përdorimit të emetimeve të përjashtuara nga regjimi i autorizimit (Pajisjet e Distancave të Shkurta (SRD))
- k) Fuqia ose intensiteti i fushës O M
- l) Gjërësia e brezit O M
- m) Frekuenca + stabiliteti O M
- n) Diagrama e antenës NP NP
- o) Lartësia e antenës/azimuti O M (pjesërisht)
- p) Koordinatat gjeografike O NP
- q) Harmonikat, intermod, parazitët O NP
- r) Tipi i modulimit O M
- s) Devijimi (FM) O M
- t) Mbulimi gjeografik NP NP

O nënkupton: mund të matet në vend

M nënkupton: mund të matet nga monitorimi

NP nënkupton: duhet aplikuar monitorimi i lëvizshëm

KAPITULLI III

PROGRAMIMI I VEPRIMTARISE SË MONITORIMIT DHE RAPORTIMI

Neni 11

Plani i Monitorimit

1. Monitorimi kryhet mbi bazën e planeve vjetore të hartuara për zbatimin e detyrave të monitorimit që burojnë nga Radio Rregulloret e ITU (ITU-R) dhe në përputhje me manualin e ITU (Monitoring Handbook – ITU), rekomandimet/vendimet CEPT.
2. Plani Vjetor i Monitorimit përcakton në detaje veprimtarinë e monitorimit që do të ndërmeret gjatë vitit ushtrimor nga AKEP, i cili përfshin ndër të tjera:
 - a) Kontrollin periodik të pikave kryesore të transmetimit në Republikën e Shqipërisë dhe sistematik të zbatimit të kushteve të përdorimit të frekuencave nga et e autorizuar për përdorim të tyre;
 - b) Verifikimin e përdorimeve të paligjshme të spektrit për identifikimin e përdoruesve të pa autorizuar;
 - c) Matje të okupimit të kanaleve specifike (FCO) për të mbështetur procesin e Autorizimeve;

- d) Matjeve të okupimit të brezave specifike (FBO) në mbështetje të administrimit të frekuencave;
 - e) Tipet e matjeve që do të kryhen, brezat e frekuencave që do të monitorohen dhe sa shpesh;
 - f) Stacione fikse të ngarkuar me projekte të paracaktuar, sipas zonave gjeografike që mbulojnë;
3. Plani Vjetor i Monitorimit propozohet nga DMFCI dhe sektorët rajonalë të Monitorimit dhe miratohet nga titullari i AKEP.
 4. Plani Mujor i monitorimit, i cili del në zbatim të Planit Vjetor, propozohet nga Sektori i Administrimit të Qendrës Kombëtare të Frekuencave, miratohet nga Drejtori i DMFCI dhe në fund të çdo muaji pararendës dorëzohet në Kabinet dhe konfirmohet nga Titullari i AKEP.

Neni 10

Autorizimi i Procesit të Monitorimit

1. Monitorimi kryehet mbi bazën e një Autorizim Monitorimi të nxjerrë nga Kryetari, rast pas rasti, sipas planit të monitorimit.
2. Autorizimi i Monitorimit hartohet nga DMFCI dhe përmban:
 - a) pikat e transmetimit që do të monitorohen
 - b) listën emërore të specialisteve të Monitorimit
 - c) llojin e matjeve që do të kryhen
 - d) datën e fillimit të monitorimit dhe afatin e përfundimit të tij
 - e) përshkrim i qëllimit dhe detyrës
 - f) pajisjet dhe antenat që do të përdoren për matjet
3. Grupi i monitorimit, në çdo rast përbëhet nga jo më pak se 2(dy) specialistë të monitorimit të frekuencave, me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta ligjore për realizimin e detyrës sipas Autorizimit të Monitorimit dhe kësaj rregulloreje.
4. Në rastet kur monitorimi në terren kryhet jashtë rrethit të Tiranës, është e detyrueshme që një anëtar i grupit të monitorimit të jetë nga personeli i Sektorit Rajonal përkatës, sipas zonës gjeografike që mbulon.
5. Dalja në terren dhe kryerja e matjeve bëhet vetëm pasi grupi i monitorimit do të jetë pajisur me Autorizimin e Monitorimit. Asnjë person nuk mund të dalë për kryerjen e matjeve pa qenë i pajisur me Autorizimin e kryerjes së monitorimit.

Neni 11

Raporti i monitorimit

1. Në përfundim të çdo procesi matjesh dhe monitorimi, personeli i përfshirë në matje përgatit raportin e monitorimit, me përmbajtje si më poshtë:
 - a) përshkrim i qëllimit dhe detyrës;
 - b) personeli i përfshirë në detyrë;
 - c) data dhe koha gjatë së cilës është kryer detyra;
 - d) pajisjet dhe antenat që janë përdorur për matjet dhe monitorim;
 - e) vlerat e matura të frekuencës, gjerësia e brezit, mbulimi, Okupimi Brezit të Frekuencave (FBO), Okupimi i Kanalit të Frekuencave (FCO), densiteti i fluksit të

- fuqisë, intensiteti i fushës, shenja e thirrjes, analizë e sinjalit etj. dhe shkeljet, nëqoftëse ka të tilla;
- f) printime me pamje nga analizatori i spektrit dhe marrësi;
 - g) kushtet mjedisore të cilat mund të ndikojnë në saktësinë e matjeve;
 - h) konkluzionet dhe rekomandime për veprime të metejshme, kur është e nevojshme
2. Raporti firmoset nga të gjithë antëret e grupit të monitorimit.
 3. Specialistët e monitorimit në sektorët rajonalë, pasi kryejnë procedurat përkatëse për monitorimin e spektrit të frekuencave në Krujë/Shkodër/Korçë/Vlorë, i dërgojnë të dhënat drejt Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave (QKMF), jo më vonë se ditën e parë të javës kalendarike, për javën pararendëse.
 4. Rezultatet e matjeve të monitorimit fiks do të regjistrohen, analizohen dhe përmbliidhen në një Raport Periodik 6-mujor.
 5. Me qëllim ruajtjen e të dhënave dhe përpunimin efektiv të tyre, të gjitha të dhënat e monitorimit ruhen në një bazë të veçantë të dhënash.

Neni 12

Aksesi në bazën e të dhënave

1. Personeli i monitorimit të spektrit të frekuencave do të ketë akses në bazën qendrore të të dhënave të përdoruesve të pajisur me Autorizim Individual për t'i dhënë mundësinë e verifikimit të kushteve të autorizimit dhe identifikimit të përdoruesve të pa autorizuar.
2. Sektori i monitorimit krijon dhe mban të përditësuar bazën e tij të të dhënave me informacion nga aktiviteti i monitorimit të transmetimeve dhe karakteristikat e matura. Ky informacion përdoret për rekordet e rastit dhe për lidhje të mëvonshme me bazën qendrore të të dhënave.

Neni 13

Raportimi

1. Sektorët Rajonalë të Monitorimit duhet të përcjellin periodikisht, çdo muaj pranë Sektorit të Administrimit të Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, raporte mbi të dhënat e monitorimit mujor.
2. Drejtorja e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit do të gjenerojë raporte periodike 6 -mujore të agreguara për informacion, të parqitura në mënyrë të hollësishme dhe analitike, në Këshillin Drejtues të AKEP.

Neni 14

Përfshirja në interferenca e stacioneve të huaja dhe qeveritare

1. Masa të veçanta aplikohen në rastet e përfshirjes në interferenca të stacioneve të huaja. Në këto raste veprohet në përputhje me nenin 15, pikën 3 të nenit 16 si dhe Shtojcën 10 të Radio Rregullores së ITU.

2. Kur në interferencë janë përfshirë stacione qeveritare zbatohen procedura specifike në bashkëpunim me institucionet qeveritare të cilat operojnë stacione radio pa pasur nevojë të pajisjen me autorizim nga AKEP, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar.

KAPITULLI IV

RREGULLA TEKNIKE TË PROCESIT TË MONITORIMIT

Neni 15

Sigurimi teknik gjatë matjeve

1. Përgjegjësi i grupit të matjeve është përgjegjës për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.
2. Ndalohet nxjerrja në operim dhe kryerja e matjeve në kushte të rënda atmosferike, veçanërisht në rastet e shkarkimeve atmosferike.
3. Në çdo rast, gjatë realizimit të matjeve stacionare duhet bërë tokëzimi i QLMSF në përputhje me rregullat e tokëzimit.
4. Stafii përdorues i QLMSF nuk duhet të qëndrojë pranë pjesëve të cilat mund të bëhen objekt goditje me pasojë dëmtimin e shëndetit (p.sh, nuk lejohet të qëndrohet përballë shtyllës teleskopike gjatë ngritjes dhe uljes së saj).
5. Nuk lejohet kryerja e matjeve nëse QLMSF nuk është vendosur në kushte optimale për realizimin e matjeve (nuk lejohet qëndrimi në vende të pjerrëta të papërshtatshme për realizimin e matjeve).
6. Montimi i antenave të nevojshme për kryerjen e matjeve bëhet në përputhje me udhëzimet e përdorimit për secilën pajisje.
7. Kycja /shkycja e burimit të ushqimit (energji elektrike) për qendrën e monitorimit bëhet në përputhje me instruksionet e përcaktuara në manualin e përdorimit.
8. Lëvizja e automjetit bëhet vetëm pasi të jetë siguruar që çdo pajisje është në vëndin e duhur dhe se levizja e automjetit nuk përbën rrezik për dëmtimin e pajisjeve.

Neni 16

Instruksionet

1. Përdorimi i pajisjeve të monitorimit bëhet në përputhje me instruksionet që përshkruajnë rrjedhën e punës dhe procedurat standarde të matjeve.
2. Instruksionet gjenden të përcaktuara në Manualet e Monitorimit (Monitoring Handbook – ITU) dhe manualet e pajisjeve që përbejnë SRFMS, QKMF, QLMSF.

Neni 17

Sigurimi i Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave

1. Qendra e Lëvizshme e Monitorimit të Frekuencave, në të cilën janë instaluar pajisjet e monitorimit, gjatë kohës që nuk është në përdorim, do të qëndrojë i mbyllur në ambientet e AKEP.
2. Në rast se gjatë kryerjes së matjeve do të jetë i nevojshëm moskthimi në ambientet e AKEP, QLMSF do të sigurohet në komisariatit e policisë së qytetit të qëndrimit ose në ndonjë repart ushtarak të afërt.

KAPITULLI V

KUNDRAVAJTJET DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 18

Kundravajtjet

1. Çdo përdorim i spektrit të frekuencave pa autorizim të lëshuar nga AKEP në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përben kundravajtje. Gjithashtu kundravajtje përben edhe përdorimi i frekuencave jo në përputhje me përcaktimet e Autorizimit.
2. Nëse gjatë kryerjes së matjeve, grupi i monitorimit evidenton kundravajtje (përdorime të paligjshëm të spektrit të frekuencave) të natyrës së sipërpermendur, do të kryhet dokumentimi i plotë i ngjarjes dhe përgatitet proces-verbali sipas shtojcës 1 (kundravajtjet duhet t’i referohen neneve përkatës të ligjit).

Neni 19

Masat Administrative

1. Anëtarët e grupit të monitorimit, pasi konstatojnë shkelje të ligjit për komunikimet elektronike, apo të kushteve të autorizimit, veprojnë në përputhje me parashikimet e nenit 134, të ligjit nr.9918, dt.19.05.2008, i ndryshuar dhe akteve rregullatore në fuqi.
2. Për zbatimin e detyrave, që burojnë nga nenet 133 e 134 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, AKEP-i bashkëpunon me autoritetet publike vendore dhe ato policore.

Neni 20

Ankimimi

1. Çdo masë e ndërmarrë nga anëtarët e grupit të monitorimit, mund të ankimohet nga sipërmarrësi (person fizik/ juridik) pranë Këshillit Drejtues të AKEP, brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 21
Shfuqizimi

1. Rregullorja nr.34, datë 23.12.2014 për *"Inspektimin, Monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative"* shfuqizohet.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues.

Shtojca 1 (Model)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AKT BLOKIMI DHE NDALIM FUNKSIONIMI TË PAJISJEVE

Sot më datë _____, në ambjentet e sipërmarrësit (person fizik/ juridik) _____ ,
bazuar në _____

Grupi i monitorimit të AKEP i përbërë nga:
_____ (Inspektor/Kryetar)
_____ (inspektor)
_____ (inspektor), dhe

Përfaqësuesi i sipërmarrësit _____,

përpilojnë këtë akt bllokimi/ndalim funksionimi te pajisjeve, si më poshtë vijon:

Konstatimet:

Gjatë matjeve të kryera dhe kontrollit fizik të pajisjeve u konstatua se:

dhe u dhanë shpjegimet nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit/punonjësi:

Konkluzionet

Përfundimisht, bazuar në faktet e konstatuara dhe shpjegimet sa më sipër, parashikimet ligjore të përcaktuara në nenet 65, 133 dhe 134, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, arrihet në përfundimin se:

Për rregullimin e shkeljeve të konstatuara rekomandojmë:

Vendimi për masat administrative

Grupi i monitorimit, bazuar në nenin 134 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

VENDOSI:

Kundra këtij akti, sipas neneve 134 dhe 136 të ligjit nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, mund të bëhet ankim administrativ brenda 10 ditëve, pranë Këshillit Drejtues të AKEP si dhe në Gjykatën kompetente.
Ky akt mbahet në dy kopje, njëra nga të cilat i dorëzohet subjektit.

NËNSHKRUAJNË

Grupi i monitorimit

Për subjektin:
